



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 1214 Prot

Maliq, më 29.2.2024

Lënda: Dërgohet Raporti i III- të i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2023

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit

Drejtoria e Financave Vendore

Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të Buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", po ju dërgojmë bashkëlidhur Raportin e III- të të Monitorimit të Buxhetit për vitin 2023 të Bashkisë Maliq si dhe pasqyrat shoqëruese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: Nën.Finance-Buxheti

G.Mukollari

Dt. ___/___/2024

Konfirmoi: Drejtor i Drejtorisë

A.Muka

Dt. ___/___/2024

Miratoi: Sek.Përgj

J.Xhialli

Dt. ___/___/2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2023

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i paraqitim Grupit për Menaxhim dhe Strategji në bashki “Raportin e III-të për monitorimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2023.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar*
- *Ligjin nr.68 /2017“Për financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr.84/2022 ” Për buxhetin e vitit 2023”*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.105 datë 19.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera”*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 106, datë 19.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023”dhe vendimin nr.5 datë 31.01.2023 “Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2023 të Bashkisë Maliq” si dhe vendimet e këshillit të marra gjatë vitit 2023, për ndryshime gjatë zbatimit të buxhetit.*

Raporti paraqet punën e administratës të Bashkisë Maliq dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Bashkisë si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit.

Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2023 është realizuar duke zbatuar me korrektësi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e këshillit bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet gjatë vitit .

MISIONI I BASHKISË MALIQ

Bazuar në ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, misioni i bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme, ushtrimit efektiv të funksioneve dhe kompetencave që ka bashkia duke realizuar shërbime cilësore në përputhje me kërkesat që ka komuniteti, gjithashtu të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie.

OBJEKTIVAT E BASHKISË MALIQ PËR VITIN 2023 janë:

- 1.Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik social, si në zonën urbane dhe atë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe rritjen e konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Maliq.
- 2.Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale për të rritur e përmirësuar akset rrugore në boshtet kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore.
- 3.Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare.
- 4.Rritja e cilësisë të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve atje ku ata banojnë.
- 5.Rritja e transparencës dhe mirëpërdorimi i fondeve publike në dobi të komunitetit.

Raporti i III-të i monitorimit përmban :

- Aneksi nr.1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;
- Aneksi nr.2 “Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë”;
- Aneksi nr.3 “Raporti i realizimit të produkteve të programit”;
- Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të programit”;
- Aneksi nr.5 “Raporti i investimeve me financim të brendshëm”;
- “Pasqyra e treguesve financiarë”

Buxheti i Bashkisë Maliq funksionon me 13 programe si me poshtë:

- | | | |
|----|-------|--|
| 1. | 01110 | Planifikim, menaxhim dhe administrim |
| 2. | 03140 | Shërbimet policore |
| 3. | 03280 | Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri |
| 4. | 04220 | Bujqësia |
| 5. | 04240 | Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitje Kullimit |
| 6. | 04260 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave |
| 7. | 04520 | Rrjeti rrugor rural |
| 8. | 06260 | Shërbimet publike vendore |
| 9. | 06330 | Furnizimi me ujë |

10. 08220 Shërbimet kulturore
 11. 09120 Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë
 12. 09230 Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm
 13. 10430 Ndihma ekonomike dhe paaftësia

Raporti i të ardhurave sipas zërave

Tabela përmbledhëse e realizimit të të ardhurave sipas zërave për vitin 2023

Nr	Emërtimi	viti 2022			viti 2023		
		Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%
	<u>Te ardhura tatimore</u>						
1	Taksë Ndërtese	27197	14178	52%	25978	13563	52%
2	Taksë Trualli	2554	2300	90%	2644	2564	97%
3	Taksë Toke	60890	25469	42%	60543	27097	45%
4	Taksë tabele	227	187	82%	200	121	61%
5	Taksë Tregu	600	346	58%	600	298	50%
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë	18600	7489	40%	19000	12261	65%
7	Tatimi i thjeshtuar	0	149		120	283	236%
8	Regj. Automjeti në përd.	12500	14646	117%	15500	16072	104%
9	T.Renta Minerale	550	266	48%	550	241	44%
10	Të ardhura nga ASHK	150	378	252%	500	661	132%
11	Të Ardhura nga Qeraja	10714	10873	101%	9011	7804	87%
12	Tatim mbi TAP	5000	12970	259%	11000	16573	151%
13	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	2600	800	31%	1600	1400	88%
	Shuma I	141582	90051	64%	147246	98938	67%
	<u>Të ardhura jotatimore</u>						
1	Tarifë Pastrimi	44698	24840	56%	39918	24578	62%
2	Tarifë Ndricimi	19725	8418	43%	16192	8017	50%
3	Tarifë Gjelberimi	3407	1947	57%	3045	1957	64%
4	Regj. Autom. në Bashki	170	467	275%	200	508	254%
5	Tarifë Parkimi	513	585	114%	700	658	94%
6	Tarifa të ≠ ne Bashki	2500	1536	61%	2500	1770	71%
7	Kullotat	600	179	30%	200	82	41%
8	Te ardhura nga drute e Zjarrit.	60000	463	1%	60000	35	0%
9	Mjete Korese	110	150	136%	160	165	103%
10	Tarife Uji per ujtje	11200	1905	17%	12200	964	8%
11	Tarife per mirembajtje kanale kulluese	6106	2016	33%	5807	2111	36%
12	Tarife Mirm Varrezash	6779	3192	47%	7543	3335	44%
13	Bileta spoti, Kulture, udhetimi	210	155	74%	210	121	58%

14	Tarifa Administrative	400	1552	388%	154	307	203%
15	Kazan Rakië	40	25	63%	40	5	12%
16	Leja Non Stop	90	60	67%	90	30	33%
17	Gjoha te #	1000	1158	116%	1200	1154	96%
18	Tarifë mjedisore	820	785	96%	825	1096	133%
19	Tarifë për mbrojtje nga zjarri	0	68		70	55	79%
20	Tarifë e drejtë televizive	0	200		1600	1367	85%
21	Sponsorizime	0	2261		0	300	
22	Tarife zenie hapësire publike	50	101	202%	100	71	71%
23	Shitje skrap	0	0	0%	0	703	
24	Ekspert Shpenzime gjyqesore	0	9			7	
	Grande	0	1000		0	1000	
	Divident nga ndarja e sektorit publik	0	891				
	Shuma II	158418	53963	34%	152754	50396	33%
	Shuma I+II	300000	144014	48%	300000	149334	50%
	TOTALI	300000	144014	48%	300000	149334	50%

Të ardhurat për 12-mujorin e vitit 2023 janë realizuar në masën 149 334 mijë lekë ose 50% të planit me një rritje prej 2% krahasuar kjo me vitin 2022.

Të ardhurat tatimore, për 12 mujorin 2023, u realizuan në shumën **98 398 mijë lekë**, ose 67 % të planit 12-mujor të vitit 2023. Krahasuar me 12 mujorin e vitit 2022 të ardhurat kanë pësuar një rritje prej 8 887 mijë lekë.

Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zënë të ardhurat e realizuara nga “*Taksa e tokës*” me një realizim të ardhurash prej 27 097 mijë lekë, “*Taksa e ndërtesës*” me një realizim të ardhurash prej 13 563 mijë lekë, të ardhurat nga qeraja me realizim 87 % me vlerë 7 804 mijë lekë, të ardhurat nga taksë ndikimi në infrastrukturë me vlerë 12 261 ose 65% të planit si dhe të ardhurat e realizuara nga agjentët tatimorë si :Të ardhura nga Tatim mbi TAP” me vlerë 16 573 mijë lekë, Të ardhura nga regjistrim automjeti në përdorim me vlerë 16 072 mijë lekë.

Të ardhurat jotatimore për 12 mujorin 2023 u realizuan në shumën **50 396 mijë lekë**, ose 33% të planit 12-mujor. Krahasuar me 12 mujorin e vitit 2022 të ardhurat kanë pësuar një rënie prej **1%**. Tarifatat që kanë ndikim të madh në mosrealizimin e planit të të ardhurave jotatimore për vitin 2023 janë “*Tarifë uji për ujitje*” me një planifikim prej 12 200 mijë lekë dhe realizim 964 mijë lekë ose 8 % të planit si dhe “*Tarifë për drutë e zjarrit*” me një planifikim prej 60 000 mijë lekë dhe realizim 35 mijë lekë ose 0% të planit. Tarifatat e tjera si tarifa e pastrimit, ndriçimit, tarifa e gjelbërimit dhe tarifatat e transportit(tarifë parkimi dhe regjistrim automjeti në bashki) krahasuar me vitin 2022 janë të gjitha me rritje.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve” për vitin 2023.

Shpenzimet faktike në fund të vitit 2023 janë realizuar në shumën 1,427,644 mijë lekë, ose realizuar 95 %, ku ndikim më të madh në realizim të ulët ka programi 0 4240 Ujitje –Kullim, janë fonde të porealizuar në shpenzime operative të caktuara për problemet e kanaleve të ujitjes dhe kullimit, një pjesë e procedurave të të cilave janë realizuar në fund të vitit, likuidimi do te bëhet në periudhat në vijim. Ndikim ka dhe programi 04520 Rrugët Rurale ku kontratat janë lidhur në fund të vitit 2023 dhe vazhdojnë dhe gjatë vitit 2024.

Tek programi 0 9120 kemi investimet në objekte shkollore ku afati i përfundimit të punimeve është në vitin 2024.

Po të analizojme planin fillestar të buxhetit dhe planin e rishikuar gjatë vitit janë bërë ndryshime me vendim të këshillit bashkiak për kalim fondesh nga një program tek tjetri ose shtesa në buxhet sipas akteve normative:

-Për arsye të akordimit të fondit nga Ministria e Arsimit dhe bashkefinancimit nga ana jonë për objektin “Rehabilitim dhe rritje kapacitetesh Gjimnazi Pojan” kemi bërë ndryshime në buxhet me VKB nr.56, datë 26.05.2023, miratuar nga prefektura me shkresë nr.475/2 prot, datë 12.06.2023, pakësim i programit 0 6260 dhe programit 0 3280 “ Blerje karburant”, pakësim i programit 0 9120 “Rehabilitim objekte shkollore” dhe shtesë fondi Bashkëfinancim projekti “Rehabilitim dhe rritje kapaciteti për Gjimnazin Pojan” në vlerën 6 500 000 lekë.

- Kemi pasur rritje të transfertës sektoriale në fondin e pagave si më poshtë:

0 3280----- 520 800 lekë

0 4240----- 1 008 000 lekë

0 4260----- 336 000 lekë

0 9120----- 3 509 918 lekë

0 9230----- 768 000 lekë

Në total 6 142 718 lekë.

- Me shkresë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nr.7063/3 prot, datë 02.08.2023 është bërë “Shtesë për paga dhe sigurime” tek gjendja civile në vlerën 1,571 mijë lekë.
- Sipas Aktit Normativ nr.6 kemi një shtesë në transfertën e pakushtëzuar me vlerë 53,555 mijë lekë. Ky fond u përdor për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kryesisht në investime për rrugë, kanale etj.

- Shtesë në buxhet me shkresë nga Ministria e Arsimit me nr.5530 prot, dt 04.09.2023 "Blerje pajisje mobilerie për Shkollën e Mesme" me vlerë 1,956 mijë lekë
- -Tek strehimi kemi një shtesë fondi me vlerë 32,371 mijë lekë për "Përmirësimin e banesave për komunitete të varfra dhe në nevojë"
- Shtesë fondi për shpërblimin e punonjësve për shuarjen e zjarreve në vlerë 940 mijë lekë.

Referuar ANEKSIT 2 "Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve", jep shpenzimet të grupuara sipas artikujve për të gjithë programet.

1.Shpenzimet korente janë realizuar në shumën 1,125,273 mijë lekë ose 97.4%, krahasuar me vitin 2022 me 105 %, ku ndikim më të madh ketu kanë shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe transfertat për ndihmën ekonomike dhe paafësinë.

Grupi i shpenzimeve kapitale është realizuar në shumën 302,371 mijë lekë ose 87 %, krahasuar me vitin 2022 me 113 %.

Programi 01110 " Planifikim, menaxhim dhe administrim"

Objektivat:

- 1.Zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
- 2.Realizimi i shërbimeve të prokurimeve publike në kohë dhe me cilësi;
- 3.Realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore;
- 4.Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor, mirëmenaxhimi i fondeve publike dhe menaxhimi i të ardhurave;
- 5.Ruajtja dhe mirëadministrimi i dokumentacionit dhe aseteve të Bashkisë;
- 6.Sigurimi i qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës të qytetarëve dhe puneve publike brenda territorit të Bashkisë si dhe ekzekutimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
- 7.Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore, mbështetja e shërbimeve për blegtorinë, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit;
- 8.Planifikimi,zhvillimi dhe kontrolli mbi territorin.

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program ku futen shpenzimet për funksionimin e strukturave të Drejtorisë së Financës, Drejtorisë të të Ardhurave, DJBNJPP, DPKZHT, IMT, Njësitë Administrative dhe strukturat mbështetëse të Kryetarit të Bashkisë.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve në programi 01110 vihet re se shpenzimet janë realizuar në masën 99 %, krahasuar me vitin 2022 me 129 %:

Programi 03140 Shërbimet policore

Objektivat:

Të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;

Të realizojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkisë
Të marrë masat e duhura, duke bashkëpunuar edhe me seksionin e shërbimeve publike me qëllim zbatimin e funksioneve të bashkisë

Numri i punonjësve në këtë sektor është 12 punonjës, shpenzimet për vitin 2023 janë realizuar në masën 96% të planit, krahasuar me vitin 2022 me 120 %.

Programi 03280 “Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri”

Objektivat:

I. Organizimi kësaj strukture për garantimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për komunitetin, blegtorinë, ndërtesat, pyjet dhe kullotat, për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijnë nga fenomene të natyrës apo nga veprimtari njerëzore.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 03280

Numri i punonjësve të planifikuar është 16 punonjës.

Shpenzimet janë realizuar në masën 90.6 % të planit, krahasuar me vitin 2022 me 87 %. Ndikim më të madh në mosrealizim kemi në fondin e investimeve.

04220 “ Bujqësia ”

Objektivat:

- Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave
- Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore

Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë.

Numri i punonjësve në këtë sektor është 9 punonjes, shpenzimet për vitin 2023 jane realizuar në masën 91.3 % të planit, krahasuar me vitin 2022 me 105.6 %

04240 “Menaxhimi infrastrukturës së ujitje-kullimit”

Objektivat:

- 1.Organizimi i punës për shrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitje kullimit me qëllim rritjen e produkteve bujqësore.
- 2.Organizimi i sistemit të kontrollit të përmbytjeve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04240

Ky program funksionon me 39 punonjës plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 78.8%, krahasuar me vitin 2022 me 78.4%. Realizim të ulët të planit kemi patur kryesisht në shpenzimet operative duke qënë se procedurat e prokurimit, kryesisht shërbim mirëmbajtje eskavatorët, janë realizuar në fund të vitit dhe kalojnë detyrimet për vitin tjetër.

04260 “Programi pyje - kullota”

Objektivat:

- 1.Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimi në mënyrë racionale i pyjeve dhe kullotave.
- 2.Organizimi dhe marrja e masave për vënien nën kontroll të sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje dhe parandalimin e zjarreve dhe fenomeneve të pa dëshirueshme në pyje.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04260

Ky program funksionon me 27 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99 % , krahasuar me vitin 2022 me 115%. Gjatë vitit 2023 kemi bërë më shumë shpenzime operative dhe investime se në vitin 2022.

04520 Rjeti rrugor rural

Objektivat :

- 1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale si rrugë, ura, sheshe publike, trotuare,vepra arti në të gjithë njesitë administrative të Bashkisë Maliq,me qëllim realizimin e lehtësimit të trafikut të mjeteve dhe lëvizjen e lirshme të qytetarëve.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04520

Ky program funksionon me 24 punonjës, plani i shpenzimeve është realizuar në masën 87.4 % krahasuar me vitin 2022 me 135.7 %.

06260 Shërbimet publike vendore

Objektivat:

1. Kryerja e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane të 6 njesive administrative ;
2. Mirëmbajtja e të gjithë institucioneve arsimore dhe administrative në shkolla dhe kopshte me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe rritjen e cilësisë të mësimdhënies.
3. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta, trotuareve, varrezave në të gjithë territorin e bashkisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.
4. Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit dhe mirembajtja e rrjetit ekzistues.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 06260

Ky program funksionon me 185 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99.4%, krahasuar me vitin 2022 me 113 % .

06330 Furnizimi me ujë

Objektivat :

1. Sigurimi i furnizimit me ujë të popullsisë të Bashkisë Maliq duke rritur cilësinë e ujit dhe orët e furnizimit nëpërmjet investimeve në ujësjellësa të rinj dhe kanalizime.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 06330

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 100%, krahasuar me vitin 2022 me 36.24%. Shpenzimet e planifikuara në këtë program janë investime që kryen Bashkia për ujësjellësa dhe KUZ. Këto janë politikat e bashkisë në drejtim të shërbimeve ndaj komunitetit për te pëmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të komunitetit dhe menaxhimin e ujrave të zeza.

08220 Shërbimet kulturore

Objektivat:

- 1.Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore;
- 2.Organizimi i eventeve kulturore për të pasur një jetë artistike të larmishme gjatë gjithë vitit duke dhënë koncerte,filma dhe shfaqje artistike;
- 3.Mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave i ambienteve për lexim në te gjithë njësitë Administrative për të rritur numrin e lexuesve nga të gjitha moshat;
- 4.Mbështetje dhe funksionim i ambienteve sportive, mbështetje ekipit përfaqësues të bashkisë si dhe ekipeve zinxhir me qëllim masivizimin e sportit, duke i orientuar nxënësit e shkollave drejt sportit dhe aktiviteteve kulturore;

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 08220

Ky program funksionon me 13 punonjës, plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99.7%, krahasuar me vitin 2022 me 99 % .

Programi 09120 “Arsimi parashkollor dhe arsimit bazë”

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore, numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 91 punonjës.

Përveç fondeve specifike për këtë program Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 09120

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 87%. Krahasuar me vitin 2022 me 95.4%. Pra gjatë vitit 2023 kemi kryer më shumë shpenzime operative dhe shpenzime për investime se në vitin 2022.

Programi 09230 “Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm”

Ky program zbatohet me fonde specifike për pagat dhe sigurimet shoqërore, numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 16 punonjës.

Përveç fondeve specifike për këtë pogram Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 09230

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 84.6 %, krahasuar me vitin 2022 me 336%. Gjatë vitit 2023 kemi bërë më shumë shpenzime operative dhe investime se në vitin 2022.

Programi 10430 “Ndihma ekonomike dhe paaftësia” ,

Janë programe që përballohen me fonde të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, planifikimi i fondeve bëhet nga ministritë përkatëse dhe realizimi është në përputhje me planin.

Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 10430

Plani i shpenzimeve vjetore është realizuar në masën 99%, krahasuar me vitin 2022 me 104.5 %

ANEKSI 3

Referuar aneksit 3 “Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës të produkteve të programit”

Ne lidhje me Aneksin 3 janë plotësuar te gjitha tabelat sipas programeve

ANEKSI 4

“Raporti i realizimit të objektivave të politikës të programit”

Për plotësimin e këtij Aneksi po punojmë për të vendosur tregues sa më realë .

ANEKSI 5 paraqet realizimin e investimeve me financim të brendshëm, për vitin përfshihen dhe investimet e kryera në vitin 2022 dhe janë likuiduar në vitin 2023.

Treguesit Financiarë

Po të analizojmë treguesit financiarë për vitin 2022 dhe planin 2023 rezulton se:

1. Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme rezulton 95 %, ky tregues është në nivel pozitiv.
2. Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme rezulton 9.9%, kjo tregon se pjesa më e madhe e buxhetit varet nga transfertat e qeverisë qendrore, por këtë

tregues do ta përmirësojmë duke punuar më shumë në drejtim të hartimit të një buxheti sa më real, organizimit të punës dhe futjes të praktikave më të mira;

3. Raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 21 %, është një tregues pozitiv .
4. Raporti i shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 29 % dhe për vitin 2023 kemi një rënie me 6%. Raporti i shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme është 38.5 %, ky është një tregues pozitiv, që vjen jo vetëm nga rritja e numrit të përfituesëve nga skema e re e ndihmës ekonomike, nga rritja e shumës të ndihmës për çdo familje, por është një tregues pozitiv i politikave që ndjek qeveria për të mbështetur këtë kontigjent në nevojë.
5. Detyrimet e prapambetura kapin vlerën 45 034 mijë lekë shpenzime për investime, kryesisht në infrastrukturën rrugore nga te cilat:
 - 27,718 mijë lekë Sistemim Asfaltim rrugë në Njësitë Administrative
 - 9,351 mijë lekë për objektin Sistemim Asfaltim rruga Vloçisht-Drithas faza II 2022
 - 4,602 mijë lekë për objektin Sistemim Asfaltim rruga Vloçisht-Drithas 2022
 - 3,363 mijë lekë Sistemim Asfaltim rrugë viti 2022 faza II

Kjo vlerë do të likuidohet me buxhetin e vitit 2024 pasi janë objekte me afat likuidimi 3 vjeçar.

Raporti i Monitorimit për vitin 2023 pasi u miratua në GMS me vendim nr.01, datë 25.01.2024 “Për miratimin e Raportit të III-të Monitorimit”, u dërgua për njohje në Këshill dhe u publikua në faqen zyrtare të bashkisë.

Faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU



ANEKSI NR. 1

RAPORTI SHPENZIMEVE SHIPAS PROGRAMEVE

BASHKIA MALIQ

në 000/leke


Titulli	Emërtimi	Shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore							(7)=(6)-(5) Diferenca
		(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti vjetor Plan Filleshtar Viti 2023	(4) Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti vjetor Plan i Periudhës/progressiv	(6) Fakti i Periudhës/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
Emri i grupit	Programet	Kodi i grupit							
0001	0 1110	168,106	228,345	228,345	233,281	218,993	216,741	(2,252)	
	0 3140	7,723	9,341	9,341	10,356	9,617	9,246	(371)	
	0 3280	19,570	22,162	22,162	24,702	18,799	17,039	(1,760)	
	0 4220	7,354	8,368	8,368	8,688	8,505	7,767	(738)	
0002	0 4240	62,099	43,909	43,909	62,714	61,781	48,683	(13,098)	
0003	0 4260	14,933	16,568	16,568	17,458	17,341	17,210	(131)	
0004	0 4520	68,734	163,958	163,958	199,829	106,800	93,291	(13,509)	
0005	0 4530							-	
0006	0 4980				410			-	
0009	0 6220							-	
0010	0 6260	160,709	184,204	184,204	204,176	183,154	182,000	(1,154)	
0011	0 6330	120,875	27,538	27,538	51,820	43,815	43,802	(13)	
	0 8130							-	
0012	0 8220	9,103	10,200	10,200	10,905	9,034	9,008	(26)	
	0 8250							-	
0013	0 9120	97,705	103,280	103,280	118,193	107,191	93,206	(13,985)	
0014	0 9230	12,902	14,057	14,057	52,131	51,328	43,425	(7,903)	
	6190	25,461			23,137	23,137	20,744	(2,393)	
0015	0 10910	24,617			77,224	77,224	60,048	(17,176)	
0017	0 1170	4,731			6,720	6,720	6,315	(405)	
	0 1620				3,040	3,040	3,036	(4)	
0018	10430	526,319			556,423	556,423	549,947	(6,476)	
0019	466	9,363					6,136		
								
	Totali i shpenzimeve të njësisë	1,340,304	831,930	831,930	1,661,207	1,502,902	1,427,644	(75,258)	
	Totali	1,340,304	831,930	831,930	1,661,207	1,502,902	1,427,644	(75,258)	
	Emri	Gëzim Topçiu							
	Firma								
	Data	22.01.2024							



Aneksi 2

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS ARTIKUJVE


ne (000) lekë

Bashkia Programi Art.	MALIQ BASHKIA MALIQ Emërtimi	Kodi i programit /							(7)=(6)-(5) Diferenca
		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor Plan fillesar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progres iv	-6 Fakti i periudhës/progre siv		
600	Paga	306,246	342,882	341,664	372,221	371,545	355,514	(16,031)	
601	Sigurime shoqërore	52,158	57,263	58,481	63,183	60,072	60,072	-	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	145,091	174,323	158,784	193,493	149,665	135,828	(13,837)	
603	Subvencione	-	-	-	-	-	-	-	
604	Transferta korrente të brendshme	19,748	-	7,350	15,569	15,734	15,635	(99)	
605	Transferta korrente të huaja	-	-	-	-	-	-	-	
606	Trans për buxh. fam. & individ	539,900	-	7,189	564,394	558,574	552,088	(6,486)	
609	Fondi rezerve + emergjencat civile	-	-	1,000	410	-	-	-	
466		9,363	-	-	-	-	6,136	-	
Nëntotali	<i>Shpenzime korrente</i>	1,072,506	574,468	574,468	1,209,270	1,155,590	1,125,273	(30,317)	
230	Kapitale të patrupëzuara	80	-	6,100	100	85	76	(9)	
231	Kapitale të trupëzuara	267,718	257,462	251,362	451,837	347,227	302,295	(44,932)	
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-	
Nëntotali	<i>Shpenzime kapitale me financim të brendshëm</i>	267,798	257,462	257,462	451,937	347,312	302,371	(44,941)	
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-	
231	Kapitale të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-	
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-	
Nëntotali	<i>Shpenzime kapitale me financim të huaj</i>	-	-	-	-	-	-	-	
Totali	Totali (korrente + kapitale)	1,340,304	831,930	831,930	1,661,207	1,502,902	1,427,644	(75,258)	
Drejftuesi i Elkëpit Menaxhues të Programit	Emri Almira Muka	Kryetari i Njësisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri						
Firma	Firma	Firma	Firma						
Data 22.01.2024	Data	Data	Data						


Bashkia Programi	MALIQ 01110 (Aparati)	Kodi i unitit / Kodi i programit							(7)=(6)-(5) Diferenca
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor fillestar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progressiv	-6 Fakti i periudhës/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	93,026	102,886	102,886	108,135	105,680	105,454	(226)	
601	Sigurime shoqërore	15,532	17,182	17,182	18,023	17,603	17,603	-	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	26,602	38,378	29,028	33,603	26,029	25,185	(844)	
603	Subvencione							-	
604	Transferta korrente të brendshme	11,327		7,350	7,350	7,515	7,503	(12)	
605	Transferta korrente të huaja							-	
606	Trans për buxh. fam. & individ	4,517		1,000	1,640	1,723	1,713	(10)	
466		9,363					6,136	6,136	
609	Fondi rezervë-emergjencat civile			1,000	410				
Nëntotali	Shpenzime korrente	160,367	158,446	158,446	169,161	158,550	163,594	5,044	
230	Kapitale të patrupëzuara	80	6,100	6,100	100	85	76	(9)	
231	Kapitale të trupëzuara	17,021	69,899	63,799	64,430	60,358	59,207	(1,151)	
232	Transferta kapitale							-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	17,101	69,899	69,899	64,530	60,443	59,283	(1,160)	
230	Kapitale të patrupëzuara							-	
231	Kapitale të trupëzuara							-	
232	Transferta kapitale							-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale	17,101	69,899	69,899	64,530	60,443	59,283	(1,160)	
	Totali (korrente + kapitale)	177,468	228,345	228,345	233,691	218,993	222,877	3,884	
Drejtesuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Kryetari i Njësisë Vetëqeverisjes Vendore	Gëzim Topçi							
	Firma	Emri							
		Firma							
	Data: 22.01.2024	Data							




Bashkia	MALIQ	Kodi i grupit / Njësise vendore						
Programi	0 1170 (Cj civile)	Kodi i programit						
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor fillestar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progress	-6 Fakti i periudhës/progress	(7)=(-6)-(-5) Diferenca
600	Paga	3,934			5,546	5,647	5,242	(405)
601	Sigurime shoqërore	657			975	874	874	-
602	Mallra dhe shërbime të tjera				199	199	199	-
603	Subvencione							-
604	Transferta korrente të brendshme							-
605	Transferta korrente të huaja							-
606	Trans për buxh. fam & individ	140						-
Nëntotali	Shpenzime korrente	4,731			6,720	6,720	6,315	(405)
230	Kapitale të patrupëzuara							-
231	Kapitale të trupëzuara							-
232	Transferta kapitale							-
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							-
240	Kapitale të patrupëzuara							-
241	Kapitale të trupëzuara							-
242	Transferta kapitale							-
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							-
Totali	Shpenzime kapitale							-
	Totali (korrente + kapitale)	4,731			6,720	6,720	6,315	(405)
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Kryetari i Njësise Vetëqeverisjes Vendore			Emri		Gëzim Topçiu		
	Firma			Firma				
	Data: 22.01.2024			Data		22.01.2024		

Bashkia	MALIQ							Kodi i grupit / Njësia	
Programi	0 3140 (Policia)							Kodi i programit	
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progresiv	-6 Fakti i periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	6,140	7,371	7,371	7,689	7,742	7,371	(371)	
601	Sigurime shoqërore	1,025	1,231	1,231	1,284	1,231	1,231	-	
602	Mallra dhe shërbime të tjera	328	739	739	1,383	644	644	-	
603	Subvencione							-	
604	Transferta korrente të brendshme							-	
605	Transferta korrente të huaja							-	
606	Trans për buxh. fam. & individ	230						-	
Nëntotali	Shpenzime korrente	7,723	9,341	9,341	10,356	9,617	9,246	(371)	
230	Kapitale të patrupëzuara							-	
231	Kapitale të trupëzuara							-	
232	Transferta kapitale							-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							-	
230	Kapitale të patrupëzuara							-	
231	Kapitale të trupëzuara							-	
232	Transferta kapitale							-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							-	
Totali	Shpenzime kapitale							-	
	Totali (korrente + kapitale)	7,723	9,341	9,341	10,356	9,617	9,246	(371)	
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Petrika Note	Kryetari i Njësies Vetëqeverisjes Vendore						Emri	
	Firma							Firma	
	Data: 22.01.2024							Data	




Bashkia	MALIQ									Kodi i grupit / Njësia	(7)=(6)-(5) Diferenca
	Programi	0 3280 (Mbrotjja nga zjarri)								Kodi i programit	
Art.	Emërtimi		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor fillestar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progresiv	-6 Fakti i periudhës/progresiv			
600	Paga		9,126	11,288	11,288	11,734	11,752	11,627		(125)	
601	Sigurime shoqërore		1,524	1,885	1,885	1,960	1,942	1,942		-	
602	Mallra dhe shërbime të tjera		2,934	8,989	2,800	4,226	4,226	3,184		(1,042)	
603	Subvencione									-	
604	Transferta korrente të brendshme									-	
605	Transferta korrente të huaja									-	
606	Trans për buxh. fam. & individ		961	6,189	6,189	6,189	286	286		-	
Nëntotali	Shpenzime korrente		14,545	22,162	22,162	24,109	18,206	17,039		(1,167)	
230	Kapitale të patrupëzuara									-	
231	Kapitale të trupëzuara		5,026				593	593		(593)	
232	Transferta kapitale									-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm		5,026				593	593		(593)	
230	Kapitale të patrupëzuara									-	
231	Kapitale të trupëzuara									-	
232	Transferta kapitale									-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj									-	
Totali	Shpenzime kapitale		5,026				593			(593)	
	Totali (korrente + kapitale)		19,571	22,162	22,162	24,702	18,799	17,039		(1,760)	
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Sadik Halli		Kryetari i Njësisë Vetëqeverisjes Vendore							Emri	
Firma										Firma	
Data	22.01.2024									Data	





Bashkia	MALIQ		Kodi i grupit / Njësia							(7)=(6)-(5) Diferenca
	Programi	0 4220 (Bujqesia)	Kodi i programit							
Art.	Emërtimi		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor Plan fillesar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plani i periudhës/progress iv	-6 Fakti i periudhës/progress siv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga		6,068	6,972	6,972	7,227	7,333	6,595	(738)	
601	Sigurime shoqërore		1,013	1,164	1,164	1,207	1,101	1,101	-	
602	Mallra dhe shërbime të tjera		22	232	232	254	71	71	-	
603	Subvencione								-	
604	Transferta korrente të brendshme								-	
605	Transferta korrente të huaja								-	
606	Trans për buxh fam & individ		251						-	
Nëntotali	Shpenzime korrente		7,354	8,368	8,368	8,688	8,505	7,767	(738)	
230	Kapitale të patrupëzuara								-	
231	Kapitale të trupëzuara								-	
232	Transferta kapitale								-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								-	
230	Kapitale të patrupëzuara								-	
231	Kapitale të trupëzuara								-	
232	Transferta kapitale								-	
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								-	
Totali	Shpenzime kapitale		7,354	8,368	8,368	8,688	8,505	7,767	(738)	
Drejtuuesi i	Ekspit Menaxhues	të Programit	Kryetari i Njësish Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Gëzim Topçiu					
	Arben Dulellari									
	Firma									
	Data: 22.01.2024									





Bashkia	MALIQ		Kodi i grupit / Njësish						
	Programi	0 4240 (Ujtye Kullimi)	Kodi i programit						
Art.	Emërtimi		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	-2 PBA Plan Viti 2023	-3 Buxheti vjetor Plan fillestar viti 2023	-4 Buxheti vjetor Plan i rishtikuar Viti 2023	-5 Buxheti vjetor Plan i periudhës/progresiv	-6 Fakti i periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga		19,197	21,361	21,361	23,355	23,498	22,667	(831)
601	Sigurime shoqërore		3,209	3,568	3,568	3,928	3,785	3,785	-
602	Mallra dhe shërbime të tjera		26,216	18,980	18,980	25,767	24,834	14,791	(10,043)
603	Subvencione								-
604	Transferta korrente të brendshme								-
605	Transferta korrente të huaja								-
606	Trans për buxh. fam. & individ		760						-
Nëntotali	Shpenzime korrente		49,382	43,909	43,909	53,050	52,117	41,243	(10,874)
230	Kapitale të patrupëzuara								-
231	Kapitale të trupëzuara		12,717			9,664	9,664	7,440	(2,224)
232	Transferta kapitale								-
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm		12,717			9,664	9,664	7,440	(2,224)
230	Kapitale të patrupëzuara								-
231	Kapitale të trupëzuara								-
232	Transferta kapitale								-
